



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1218/1 Prot.

Tiranë, më 08.09.2022

V E N D I M

Nr. 174, Datë 08.09.2022

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 49, datë 04.03.2022¹, e B.H kundër Zyrës Përmbarimore Vlorë, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “etnisë²”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës dhe me shkresën datë 28.03.2022, subjekti ankues në mes të tjerash informon se: “Me Vendimin nr. 293, datë 27.02.2016, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, ka pranuar padinë dhe ka vendosur: - Detyrimin e palës së paditur M.M të lirojë dhe dorëzojë pasurinë me sipërfaqe 164 m², të ndodhur brenda pasurisë me sipërfaqe 472 m², nr. 16/158, vol. 22, faqe 36, e ndodhur në Vlorë.

Vendimi është ankimuar nga M.M, dhe Gjykata e Apelit Vlorë, me Vendimin nr. 512, datë 10.07.2019, ka vendosur lënien në fuqi të Vendimit nr. 293, datë 27.02.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Ankuesi, në datë 31.10.2019, i drejtohet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë për të kërkuar lëshimin e urdhërit të ekzekutimit.

¹ Me shkresën nr. 411/1, datë 10.03.2022 Komisioneri ka kërkuar plotësimin e ankesës me dokumentacion. Ankuesi me shkresën e protokolluar me tonën, me nr. 518, datë 28.03.2022, ka dërguar informacion dhe dokumentacion plotësues.

² Referuar shkresës nr. 499, datë 24.03.2022, të lëshuar nga organizata “Një zë i barabartë Romë-Egjiptianë në komunitetin Vlonjat”, vërtetohet se B.H është anëtar i komunitetit egjiptian.

Gjykata në Vendimin nr. 2041, datë 11.11.2019 vendosi: - Pranimin e Kërkesës. - Lëshimin e Urdhërit të Ekzekutimit për Vendimin nr. 293, datë 27.02.2016 e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, të lënë në fuqi me Vendimin nr. 512, datë 10.07.2019, e Gjykatës së Apelit Vlorë.

Pas dhënies së vendimit, Zyra Përmbartimore Vlorë, fillon procedurën e ekzekutimit të vendimit, duke bërë lajmërim për ekzekutim vullnetar, në datë 30.12.2019. Nga ana e Zyrës Përmbartimore Vlorë është kërkuar ekspertja për të sqaruar dhe interpretuar Vendimin nr. 293, datë 27.02.2016 e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Kjo e fundit me Vendimin nr. 945, datë 11.11.2020 vendosi pushimin e gjykimit, duke arsyetuar se vendimi është i qartë dhe nënkupton vetëm lirim dhe dorëzim sendi dhe jo prishje objekti. Ekzekutimi i vendimit në bazë të lëshimit të urdhërit të ekzekutimit është kërkuar të bëhet në disa data nga ana e përmbartuesit gjyqësor, i mbështetur nga forcat e rendit dhe nga përfaqësuesit e Bashkisë Vlorë, por për shkaqe nga më të ndryshmet, datat shtyheshin duke krijuar vështirësi në ekzekutimin e vendimit. Përpjekjet e mia si kreditor dhe pronar i objektit nuk janë ndalur, pasi shpesh herë kam dërguar kërkesa për informacion jo vetëm në Zyrën Përmbartimore Vlorë por dhe në Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbartimit. Më në fund pas gjithë zvarritjeve që më janë bërë, me datë 14.01.2021 është bërë ekzekutimi i detyrueshëm nga Zyra Përmbartimore Vlorë, ku është bërë dhe dorëzimi i banesës tek unë, si pronar. Bashkëlidhur ankesës do gjeni procedurën (dhe gjyqet e fituara), ku duket qartazi zvarritja dhe diskriminimi që më është bërë, pasi i përkas komunitetit egjiptian.

Ajo që kërkoj dhe që kam kërkuar gjatë gjithë kësaj periudhe është, të më kthehen pas gjithë shpenzimet e kryera për ekzekutimin e vendimit nga ana e Zyrës Përmbartimore Vlorë, të cilat kapin vlerën 110.660 lekë të reja. Në bazë të kërtimeve të mia jam vënë në dijeni se Zyra Përmbartimore Vlorë ka derdhur në llogarinë time, në datë 12.10.2021, shumën prej 21.900 lekë të reja”.

Subjekti ankues kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe detyrimin e Zyrës Përmbartimore Vlorë që t’i kthejë shpenzimet e kryera.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: “‘Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore

të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Neni 5, i ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, parashikon ndalimin e diskriminimit për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji. Sipas këtij neni ndalohej gjithashtu mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, të një ankimi ose procedure, si dhe çdo formë tjetër sjelljeje, që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë.

Në bazë të nenit 7, të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Në Kreun III, të ligjit të sipërcituar parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e të mirave dhe shërbimeve. Ky ligj në nenin 20, pika 1, të tij parashikon se: *“1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohej të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato: a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi”.*

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

Pas analizimit paraprak të ankesës nr. 49, datë 04.03.2022, të bërë nga B.H, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo nuk i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar. Në këto kushte Komisioneri, me shkresën nr. 411/1, datë 10.03.2022, ka kërkuar nga ankuesi plotësimin e ankesës me shpjegime dhe dokumentacion.

Ankuesi me shkresën e protokolluar me tonën me nr. 518, datë 28.03.2022, dërgoi informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar.

Në këto kushte, Komisioneri filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

1. Me shkresën nr. 411/2, datë 11.04.2022, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe ka kërkuar informacion nga, Zyra e Përmbaarimit Vlorë (në vijim do i referohemi si Z.P. Vlorë), për ankesën e bërë nga B.H si dhe ka kërkuar aktet e poshtë cituara:
 - Kopje të plotë të dosjes përmbaarimore për ekzekutimin e Vendimit nr. 293, datë 27.02.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.
 - Kopje të të gjithë ankesave të bëra nga B.H, drejtuar Z.P Vlorë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbaarimit dhe përgjigjeve të dhëna.
 - Informacion nëse ka dhe dosje të tjera përmbaarimore, (të cilat janë në kushte të njëjta apo të ngjashme me ankuesin) të cilat kanë 2 vite apo më shumë, që nuk janë ekzekutuar.

Me shkresën nr. 530/1, datë 19.04.2022, Z.P. Vlorë, në mes të tjerash informoi Komisionerin se:
“Pranë Z.P Vlorë, në datën 16.12.2019 është regjistruar dosja Përmbaarimore, për ekzekutimin e Vendimit nr. 293, datë 27.02.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, me palë: Kreditor: B.H; Debitor: M.M; Objekt: Lirim – Dorëzim;

- *Në datë 16.12.2019, me shkresën nr. 1270 është bërë Urdhër regjistrimi.*
- *Në datë 16.12.2019 me shkresën nr. 1270 është bërë Urdhër mbi Vënien e Taksës.*
- *Në datë 30.12.2019 është bërë lajmërim për ekzekutim vullnetar.*
- *Në datë 16.01.2020 është marrë vendim për kalim në ekzekutim të detyrueshëm.*
- *Në datë 28.01.2020 është marrë vendim për caktim ekspert.*
- *Në datë 10.02.2020 është dërguar Kërkesë për mbështetje, Komisariatit të Policisë dhe Bashkisë Vlorë, si dhe institucioneve përkatëse.*

Në datë 24.02.2020 është shkuar në vend ekzekutim, në lagjen “Hajro Çakërri”. Kanë qenë prezent të gjithë përveç debitorit. I është dhënë detyra ekspertes të përcaktojë veprimet që do të kryhen nga Z.P Vlorë në bazë të vendimit. Ekspertja deklaroi se për ekzekutimin e këtij vendimi duhen mjete që të bëjnë të mundur prishjen e ndërtimeve të paligjshme. Në mungesë të mjeteve Z.P. Vlorë është tërhequr për të lënë një datë tjetër ekzekutimi.

Në datë 09.03.2020 është dërguar përsëri Kërkesë për mbështetje Komisariatit të Policisë Vlorë, por për shkak të situatës së pandemisë, Z.P.Vlorë në bazë të Aktit Normativ nr. 525, datë 11.03.2020, ka pezulluar të gjitha veprimet.

Në datë 01.06.2020, Z.P. Vlorë me shkresën nr. 688, ka caktuar ekzekutimin në datën 25.06.2020.

Në datë 25.06.2020 u paraqitën në vend ekzekutim. Të gjitha palët kishin dijeni, mungonte debitori, por në prani të përfaqësuesit të bashkisë, nuk është problem mungesa e tij. Kryeinspektori i IMT Bashkia Vlorë, z. Z.S deklaroi se për të bërë të mundur prishjen e sendit objekt ekzekutimi më parë duhet të bëhet shpëputja e energjisë elektrike, si dhe lidhja e ujit të pijshëm. Këto dy kërkesa ai i bën vetëm sot në ditën e ekzekutimit edhe pse kishte marrë dijeni,

në bazë të dëftesave të komunikimit që në datë 12.06.2020. Inspektorët e IKMT Vlorë deklarojnë se institucioni i tyre nuk ka mjete për prishje të ndërtimeve të paligjshme, por funksionon si inspektoriat ku ndalon këto ndërtime.

Të ndodhur para këtij fakti, Z.P Vlorë në këtë ditë do të lirojë dhe dorëzojë pjesën e truallit të pa zënë nga ndërtimet e paligjshme. I jepet detyra ekspertës e cila përcakton pjesën që është e lirë dhe mund të ekzekutohet pa pasur nevojën e mjeteve të rënda siç është skrepi. Ekspertja përcakton se do të prishet një mur prej 5 m gjatësi dhe 70 cm lartësi. Z.P. Vlorë bën të mundur ekzekutimin për pjesën e pazaptuar nga ndërtimet dhe në pritje të institucioneve që bëjnë prishjen e ndërtimeve të paligjshme. Nga Z.P Vlorë është caktuar data 15.07.2020, për ekzekutimin e vendimit të mësipërm.

Me shkresën nr. 3534/I, datë 10.07.2020, Komisariati i Policisë Vlorë njofton se është në pamundësi për të na mbështetur me forca në ekzekutim në datë 15.07.2020. Z.P. Vlorë në datë 04.08.2020 ka caktuar si datë ekzekutimi, datën 08.09.2020.

Në datë 08.09.2020 u shkua në vend ekzekutim. Palët kishin dijeni të gjitha dhe të pranishëm ishin kreditori, debitori, Komisariati i Policisë, pushteti vendor, ekspertja znj. F.F, IMT Bashkia Vlorë, në mbështetje me mjetin tip skrep dhe IKMT.

Ekspertja pasi përcaktoi sipërfaqen e truallit objekt lirim-dorëzim konstatoi:

- Sipërfaqja totale për t'u liruar është 164 m².*
- Në këtë sipërfaqe, 63.7 m² është e zënë me ndërtim që përbëhet nga dy dhoma dhe një tualet në katin përdhe dhe në katin e dytë dy dhoma koridor + 1 tualet.*

Ndërkohë përfaqësuesi i palës debitore Av. K.M. deklaroi se ky vendim është i paqartë, pasi gjykata nuk ka përcaktuar sipërfaqen ndërtimore që debitori ka blerë nga kreditori, e provuar dhe e pranuar nga B.H, gjatë gjykimit.

Në gjithë pjesën arsyetuese vendimi konstaton dhe pohon se debitori M.M. ka blerë nga kreditori një dhomë me përmasa 3x3 dhe një koridor, kjo e pohuar dhe nga kreditori. Në të gjithë pjesën arsyetuese vendimi lë të kuptohet se debitori M.M përveç një dhomë me përmasa 3x3 dhe një koridor që ka blerë nga kreditori, mban të rrethuar dhe një sipërfaqe prej 164 m², ndërkohë që brenda sipërfaqes 164 m², ndodhet edhe ndërtimi 63.7m², përfshirë edhe sipërfaqen prej një dhome me përmasa 3x3 dhe një koridor që ka blerë nga kreditori. Nga ana e përmbaruesit iu kërkua ekspertës të përcaktojë sipërfaqen prej një dhome me përmasa 3x3 dhe një koridor të blerë prej debitorit. Ekspertja deklaroi se e ka të pamundur përcaktimin e kësaj sipërfaqe pasi nuk i është kërkuar prej gjykatës apo palëve në proces. Për sa më lart, duke qenë se nga ana e ekspertit ishte e pamundur përcaktimi në fakt i kësaj sipërfaqe ndërtimore, përmbaruesi vijoi me lirimin dhe dorëzimin e sipërfaqes se truallit prej 100.3m², ndërsa për sipërfaqen ndërtimore prej 63.7m², i jemi drejtuar gjykatës me kërkesë për plotësim saktësim dhe interpretim vendimi. Pasi u zhvillua seanca gjyqësore, Gjykata vendosi pushimin e çështjes dhe shpjegoi në sallë se vendimi është i qartë dhe nënkupton vetëm lirim-dorëzim të pasurisë, jo prishje të objektit. Në datë 14.12.2020, Z.P Vlorë ka caktuar datën 28.12.2020, për ekzekutimin e

vendimit. Në bazë të dëftesave të komunikimit kanë marrë dijeni kreditori, debitori, Policia e Shtetit dhe nuk kanë marrë dijeni përfaqësuesit e Bashkisë Vlorë. Në kushtet kur debitori ka paraqitur raport dhe përfaqësuesi i pushtetit vendor mungon, Z.P Vlorë nuk mund të vazhdojë me çeljen e banesës. Z.P. Vlorë në datë 31.12.2020 ka caktuar ekzekutimin në datë 14.01.2021. Në datën e caktuar nga Z.P. Vlorë shkohet në ekzekutim dhe bëhet e mundur lirimi dhe dorëzimi i ambjenteve që janë objekt ekzekutimi dhe i kalohen kreditorit. Të ndodhur në kushtet që debitori nuk është prezent, Z.P. Vlorë do të lërë në ruajtje të gjitha orenditë shtëpiake që u gjenden në brendësi të banesës së debitorit, për një periudhë dy mujore.

Në datë 09.09.2020 Z.P Vlorë ka kaluar në sekuestro për vjeljen e shpenzimeve gjyqësore. Nga përgjigja e bankave të nivelit të dytë rezulton se debitori M.M nuk ka llogari në këto banka. Nga ASHK Vlorë dhe institucionet e tjera nuk ka pasur përgjigje në lidhje me pasuri ose aktivitete që ushtrohen nga debitori. Në bazë të informacionit të sjellë nga kreditori për debitorin ku na vendos në dispozicion dhe dy pasuri të paluajtshme nga Z.P Vlorë është dërguar shkresë pranë ASHK Vlorë në datë 29.01.2021 për sekuestrimin e këtyre dy pasurive. Nga Z.P Vlorë janë bërë të gjitha procedurat për ekzekutimin dhe vjeljen e shpenzimeve gjyqësore dhe do të vijojmë me ekzekutimin sipas ligjit dhe K.P.Civile. Me shkresën nr.750, datë 16.03.2021 i jemi drejtuar palës debitore për marrjen e sendeve të luajtshme sepse data që përkonte me afatin dy mujor, datë 14.03.2021 ishte festë zyrtare. Në datë 23.03.2021 shkojmë pranë sendit objekt ekzekutimi dhe prezent ishin Z.P Vlorë, përfaqësuesi i Rajonit nr.1 dhe kreditori B.H, i cili deklaroi se nuk ka marrë asnjë masë për transportin dhe magazinimin e sendeve të debitorit. Nga kontaktet verbale me Drejtorinë e Rezervave të Shtetit deklaroi se as në magazinat e këtij institucioni nuk ka mundësi për magazinimin e këtyre sendeve. Në datë 19.05.2021 sendet u hoqën nga banesa dhe u çuan në dyqan për shitje të lirë. Shuma e përfituar nga shitja e tyre ka qenë 16.500 lekë, e cila ka kaluar në llogari të Z.P Vlorë dhe do të kalojë në llogari të kreditorit. Z.P. Vlorë ka sekuestruar një pasuri në ASHK Vlorë dhe nga kartela e pasurisë së ardhur në Z.P. Vlorë rezulton se kjo pasuri është Hipotekuar në favor të BKT dhe se s'ka pasuri të tjera në emër të debitorit M.M. Në datë 02.09.2021, me shkresën nr. 688, Z.P Vlorë i është drejtuar Bankës Kombëtare Tregtare me kërkesë për informacion. Me shkresën nr. 19205/1, BKT informon se afati i maturimit të kredisë është data 12.06.2026. Me shkresën nr. 688, datë 26.08.2021 nga Përmbartuesi Gjyqësor janë përsëritur sekuestrot drejtuar Bankave të nivelit të dytë si dhe institucioneve të tjera. Përgjigjet janë negative. Nga Raiffeisen Bank me shkresën nr. 463/1, datë 13.09.2021 na bëhet me dije se janë bllokuar 46 euro, shumë e cila i ka kaluar kreditorit. Me datë 08.10.2021 kreditorit i ka kaluar edhe shuma prej 16.000 lekë e përfituar nga shitja e sendeve të luajtshme të debitorit në treg të lirë. Në datë 18.03.2022 me shkresën nr. 1019, janë përsëritur sekuestrot drejtuar Bankave të nivelit të dytë dhe jemi në pritje të përgjigjeve. Nga sa më sipër rezulton se Z.P Vlorë asnjë herë nuk është bërë pengesë për ekzekutimin e vendimit dhe aq më tepër të këtë pasur si qëllim zvarritjen e ekzekutimit, pasi të gjitha veprimet janë kryer në përputhje të plotë me parashikimet ligjore përkatëse”.

Në përgjigje të shkresës së Z.P. Vlorë, ankuesi me shkresën e datës 28.04.2022 ka kundërshtuar informacionin e Z.P. Vlorë dhe në mes të tjerash ka informuar se: “Nga shitja e sendeve, atij i

kanë kaluar në Bankës Credins vetëm 2.000 lekë, ndërsa Z.P Vlorë deklaroi se ka paguar 16.500 lekë”.

2. Me shkresën nr. 411/4, datë 09.05.2022, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka kërkuar informacion shtesë nga Z.P. Vlorë dhe ka kërkuar dokumentacionin e poshtëcituar:

- Kopje të plotë të dosjes përmbartimore për ekzekutimin e Vendimit nr. 293, datë 27.02.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.
- Kopje të të gjithë ankesave të bëra nga B.H, drejtuar Zyrës Përmbartimore Vlorë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbartimit dhe përgjigjeve të dhëna.
- Informacion nëse ka dhe dosje të tjera përmbartimore, (të cilat janë në kushte të njëjta apo të ngjashme me ankuesin) të cilat kanë 2 vite apo më shumë, që nuk janë ekzekutuar.

Me shkresën nr. 123/18, datë 31.05.2022, Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit (në vijim do t'i referohemi si DPP), informoi Komisionerin me konstatimet e verifikimit të dosjes objekt shqyrtimi, duke shpjeguar se: *“Në përfundim të verifikimit të dosjes përmbartimore me palë kreditore – B.H; debitore – M.M; objekt - lirim dorëzim sendi, kthim shume, konstatohet se nga ana e Z.P Vlorë janë ndjekur veprime përmbartimore për ekzekutimin e Urdhrit të Ekzekutimit, Vendimit nr. 2041, datë 11.11.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, lëshuar për Vendimin nr. 293, datë 27.02.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, lënë në fuqi me Vendimin nr. 512, datë 10.07.2019 të Gjykatës së Apelit Vlorë, në zbatim të Kodit të Procedurës Civile, ku ndër të tjera rezulton se:*

- *Nga ana e përmbartuesit gjyqësor është kryer lajmërim për ekzekutim vullnetar; vendim për kalim në ekzekutim të detyrueshëm; vendim për caktim ekspertit për përcaktimin në terren të sipërfaqes që do të dorëzohet; kërkesa të përsëritura për mbështetje në ekzekutim në vendin objekt ekzekutimi, drejtuar IKMT, IMT e Bashkisë Vlorë, Komisariatit të Policisë Vlorë; Kërkesë për marrjen e sendeve të luajtshme të debitorit në dorëzim; Urdhra të përsëritura për vënien e masës sekuestro konservative, drejtuar Bankave të Nivelit të Dytë, ASHK Drejtoria Vendore Vlorë, DRTT Vlorë, DRSHTRR Vlorë.*
- *Nga ana e përmbartuesit gjyqësor është bërë i mundur ekzekutimi i vendimit gjyqësor duke liruar dhe dorëzuar sendin e paluajtshëm objekt ekzekutimi në favor të palës kreditore B.H.*
- *Sa i përket kthimit të shumës (shpenzime gjyqësore+tarifë përmbartimore+shpenzime përmbartimore) nuk është bërë i mundur ekzekutimi, pasi nga përgjigjet e kthyer nga Bankat e Nivelit të Dytë nuk rezulton llogari me balancë pozitive në favor të palës debitore. Ndërkohë, me shkresën nr. 688, datë 24.09.2021 është bërë urdhër për vënien e masës sekuestro ekzekutive, drejtuar Raiffeisen Bank, për shumën 46 euro të bllokuara me urdhër sekuestro konservative në llogari të debitorit.*
- *Në kartelën e pasurisë nr. 17/231-N30 të palës debitore M.M për të cilën është vënë sekuestro konservative, rezulton shënimi “Hipotekuar në favor të BKT”.*

Për sa më sipër, Z.P Vlorë do të vijojë me veprimet përmbare, sa i përket kthimit të shumës (shpenzime gjyqësore, tarifë përmbare dhe shpenzime përmbare) në favor të palës kreditore B.H, konform dispozitave të Kodit të Procedurës Civile”.

Me shkresën nr. 658/1, datë 18.05.2022, Zyra e Përmbaremit Vlorë, përsëriti informacionin e dërguar me shkresën nr. 530/1, datë 19.04.2022, dhe dërgoi një kopje të dosjes objekt shqyrtimi dhe në mes të tjerash informoi Komisionerin se: *“Në lidhje me kërkesën për dosje të ngjashme me dosjen e ankuesit, ju informojmë se ka të tilla që janë në ekzekutim, ose që janë pezulluar kur ka kaluar një afat më shumë se dy vjet që janë përsëritur urdhrat e sekuestrove dhe përgjigjet kanë qenë negative”.*

Mbështetur në nenin 33/8, të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës nr. 49, datë 04.03.2022, Komisioneri me shkresat nr. 411/8, datë 13.06.2022 dhe nr. 411/9, datë 15.06.2022 njoftoi, palët për zhvillimin e seancës dëgjimore me datë 24.06.2022, për të parashtruar dhe argumentuar në mënyrë të drejtpërdrejtë pretendimet e tyre, si dhe kërkoi kopje e dokumentacionit, si më poshtë:

- Shpjegime të përmbledhura dhe kopje të dosjeve të tjera përmbare (që janë në kushte të njëjta apo të ngjashme me ankuesin) për të cilat Z.P Vlorë ka informuar se ka, dhe janë në proces ekzekutimi ose që janë pezulluar.

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, seanca dëgjimore u regjistrua audio dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Seanca u zhvillua në datë 24.06.2022, me praninë e të dy palëve në proces: subjekti ankues, B.H, si dhe palës kundër së cilës është paraqitur ankesa, përfaqësuesit me autorizim³ të Z.P Vlorë, z. K.K dhe përfaqësueses me autorizim⁴ të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbaremit, znj. E.T.

Gjatë seancës dëgjimore, palët iu qëndruan të njëjtave parashtrime që kishin bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në dhe që do të shtjellohen në vijim, gjatë arsyetimit të vendimit.

Gjatë seancës dëgjimore, ankuesi parashtroi edhe një herë pretendimet e tij për diskriminim për shkak të etnisë, si dhe parashtroi se ka kërkuar kthimin e pagesave të bëra për ekzekutimin e vendimit gjyqësor, shpenzime që arrijnë shumën prej 120.000 lekë nga të cilat ka marrë shumën prej 20.000 lekësh.

Përfaqësuesi i Z.P Vlorë në mes të tjerash parashtroi se gjatë vitit 2020 gjatë periudhës së pandemisë, veprimtaria e zyrave përmbarese ka qenë e pezulluar për një periudhë prej gjashtë muajsh. Vendimi i gjykatës për lirim dhe dorëzim objekti është ekzekutuar dhe B.H i kanë kaluar në llogari vlera prej 16.000 lekë nga shitja e sendeve të sekuestruara dhe 46 euro të sekuestruara në një bankë të nivelit të dytë. Vendimi i ekzekutimit të dosjes përmbare është në proces për pjesën e rimbursimit të shpenzimeve të bëra nga B.H, pasi debitori ka një pasuri të paluajtshme e cila është lënë si kolateral në

³ Referuar Autorizimit nr. 893, datë 23.06.2022 të Z.P Vlorë.

⁴ Referuar Autorizimit nr. 1111, datë 16.06.2022 të DPP.

një bankë të nivelit të dytë dhe deri në vitin 2026, që pasuria të lirohet nga detyrimi, ne si zyrë përmbartimi nuk mund të veprojmë mbi këtë banesë.

Gjithashtu, përfaqësuesi i Z.P Vlorë depozitoi shkresën me nr. 893/1, datë 23.06.2022, në të cilën ka renditur të gjitha veprimet përmbartimore të kryera nga ana e kësaj zyre dhe ndër të tjera, ka cituar dhe disa dosje të tjera me objekt kthim shume të paekzekutuara pasi rezulton që debitorët nuk kanë pasuri, si më poshtë:

- M.I – V.V kthim shume e regjistruar prej vitit 2012.
- S.S – XH.RR kthim shume e regjistruar prej vitit 2011.
- Y.E – A.A kthim shume e regjistruar në vitin 2019 dhe vazhdon në proces ekzekutimi.
- B.K – A.V kthim shume e regjistruar në 2008 dhe vazhdon akoma të jetë e paekzekutuar në status pezulluar.

Gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesja e Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbartimit, në mes të tjerash deklaroi se: *“Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit ka kryer hetim administrativ të dosjes përmbartimore të B.H si dhe ka trajtuar të gjitha kërkesat/ankesat e bërë nga ai dhe në përfundim është konstatuar se titulli ekzekutiv kryesor që është lirimi dhe dorëzimi i objektit është ekzekutuar nga ana e Z.P Vlorë. Arsyeja e zvarritjes ka ardhur për faktin se gjatë periudhës së pandemisë (2020) veprimtaria përmbartimore në 22 zyrat e përmbartimit në vend ka qenë e pezulluar, sidomos për objektet në terren për lirim dhe dorëzim sendi. Nga ana e Z.P Vlorë janë kryer të gjitha veprimet që parashikon Kodi i Procedurës Civile. Detyra e Z.P. Vlorë është të bëjë urdhër për vendosjen e masës së sekuestros konservative, drejtuar të gjitha institucioneve, përfshirë bankat e nivelit të dytë, Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, Drejtorinë e Shërbimit të Transportit Rrugor për bllokimin e dokumenteve të automjeteve që mund të ketë pala debitorë, Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve nëse ka aktivitet privat që të bllokohen sendet e luajtshme të aktivitetit. Referuar akteve në dosjen përmbartimore të gjitha këto veprime janë kryer nga Z.P Vlorë dhe përgjigjet e institucioneve kanë qenë negative dhe në këto kushte kur debitori nuk ka asnjë lloj pasurie të sekuestrueshme nga ana e palës debitorë, nuk ka se ç’farë shume ti kthehet kreditorit, pasi janë ezauruar të gjitha procedurat ligjore, por nga ana e Z.P Vlorë do bëhen veprime të herëpashershme duke iu drejtuar institucioneve për vendosjen e sekuestros së pasurisë së debitorit”.*

Në vijim të seancës dëgjimore, ankuesi me shkresën e datës 09.07.2022, të protokolluar me tonën me nr. 1011, datë 12.07.2022, ka dërguar dhe njëherë formularin e ankimit së bashku me korrespondencat e mbajtura me institucionet: Ministrinë e Drejtësisë, Avokatin e Popullit dhe Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas, si dhe ka dërguar disa vendime të gjykatave të lidhura me çështjen në shqyrtim.

Ankuesi me shkresën e datës 08.08.2022, të protokolluar me tonën me nr. 411/12, datë 08.08.2022, ka informuar Komisionerin mbi pretendimet për diskriminim për shkak të etnisë që po ushtrohet ndaj tij nga individë dhe në institucione të tjera (Prokuroria Vlorë).

Në vijim të seancës dëgjimore, përfaqësuesi i Z.P Vlorë, me e-mail-in datë 26.08.2022 dërgoi tre praktika përmbartimore, në emër të shtetasve: A.N, B.K dhe N.I, me objekt kthim shume të cilat janë ende në ekzekutim pranë Z.P Vlorë.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Mbështetur në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri vlerëson se:

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë të ankuesit.

Subjekti ankues, ka ngritur pretendime ndaj Zyrës Përmbartimore Vlorë, lidhur me vonesat në ekzekutimin e Vendimit nr. 2041, datë 11.11.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë “*Për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit për Vendimin nr. 293, datë 27.02.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, lënë në fuqi me Vendimin nr. 512, datë 10.07.2019 të Gjykatës së Apelit Vlorë*”, në favor të kërkuarit B.H dhe mosekzekutimin e vlerës së shpenzimeve gjyqësore dhe të tarifës përmbartimore të bëra nga ana e ankuesit për ekzekutimin e vendimit të mësipërm.

Referuar dokumentacionit të administruar gjatë procesit të hetimit, shkurtimisht po citojmë veprimet kryesore të bëra nga Z.P Vlorë, për ekzekutimin e vendimit të mësipërm.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë me Vendimin nr. 2041, datë 11.11.2019 vendosi: - Pranimin e Kërkesës. - Lëshimin e Urdhërit të ekzekutimit për Vendimin nr. 293, datë 27.02.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, të lënë në fuqi me Vendimin nr. 512, datë 10.07.2019 të Gjykatës së Apelit Vlorë.

Me datë 19.11.2019 është bërë kërkesë nga B.H drejtuar Z.P Vlorë për ekzekutimin e vendimit të mësipërm.

Me shkresën nr. 1720, datë 30.12.2019 të Z.P Vlorë është kryer lajmërim për ekzekutim vullnetar, drejtuar palës debitore.

Me shkresën nr. 1720, datë 16.01.2020 të Z.P Vlorë është nxjerrë vendim për kalim menjëherë në ekzekutim të detyrueshëm.

Me shkresën nr. 688, datë 28.01.2020 është nxjerrë vendim për caktimin e ekspertit për vlerësimin e sendeve të paluajtshme, duke caktuar ing. F.F, për përcaktimin në terren të pasurisë 164 m², të ndodhur brenda pasurisë me sipërfaqe 472 m².

Me shkresën nr. 688, datë 09.03.2020 të Z.P Vlorë është bërë kërkesë për mbështetje në ekzekutim për datë 25.03.2020, drejtuar Komisarariatit të Policisë Vlorë, Bashkisë Vlorë, Rajoni 1, Ing. F.F, IKMT, IMT Vlorë, debitorit dhe kreditorit.

Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Përmbartimor Gjyqësor ka miratuar Urdhrin nr. 525, datë 11.3.2020, “*Për pezullimin e veprimtarisë dhe shërbimeve në Shërbimin Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror*”, për shkak të situatës së krijuar nga përhapja e infeksionit COVID-19, për një periudhë 2 javore nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

Këshilli i Ministrave në nenin 3, pika 1 të Aktit Normativ nr. 13, datë 02.04.2020 “*Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë së shërbimit përmbartimor gjyqësor, ndërmjetësimi*

dhe administrimit të procedurave të falimentimit gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19”, ka vendosur se: “Nga data e hyrjes në fuqi të këtij akti normativ deri në përfundimin e gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga përhapja e COVID-19 pezullohen afatet për kryerjen e veprimeve procedurale të përmbaruesit gjyqësor shtetëror apo privat, ndërmjetësit dhe administratorit në procedurat e falimentimit. Kur afatet për kryerjen e veprimeve procedurale sipas parashikimit të legjislacionit në fuqi fillojnë gjatë periudhës së pezullimit, ato shtyhen deri në përfundimin e gjendjes së epidemisë”.

Me shkresën nr. 688, datë 01.06.2020, të Z.P Vlorë është bërë kërkesë për mbështetje për ekzekutim në datë 25.06.2020, drejtuar Komisarariatit të Policisë Vlorë, Bashkisë Vlorë, Rajoni 1, Ing. F.F, IKMT, IMT Vlorë, debitorit dhe kreditorit.

Me datë 25.06.2020 është mbajtur procesverbal, ku deklarohet se përmbaruesi gjyqësor është paraqitur pranë vendit objekt ekzekutimi në prani të policisë, pushtetit vendor, palës kreditore, ing. F.F, të cilës ju la detyra për përcaktimin e sipërfaqes që do të lirohet/dorëzohet sipas vendimit të gjykatës.

Me shkresën nr. 688, datë 09.09.2020, të Z.P Vlorë është bërë Urdhër për vënien e masës sekuestro konservative, drejtuar ASHK Vlorë.

Me shkresën nr. 688, datë 09.09.2020 të Z.P Vlorë është bërë Urdhër për vënien e masës sekuestro konservative në automjetet e debitorit, drejtuar Drejtorisë Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor, Vlorë.

Me shkresën nr. 688, datë 09.09.2020 të Z.P Vlorë është bërë Urdhër për të përcjellë informacion nëse debitori ushtron aktivitet privat apo jo, drejtuar Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë.

Me shkresën nr. 688, datë 09.09.2020 të Z.P Vlorë është bërë Urdhër për vënien e masës sekuestro konservative në llogaritë e debitorit, drejtuar Bankave të Nivelit të Dytë.

Me Vendimin nr. 945, datë 11.11.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë është vendosur pushimi i çështjes civile nr. 945, datë 12.01.2020, me objekt kërkesë “*Sqarimin e vendimit nr. 293, datë 27.02.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë*”.

Me shkresën datë 07.12.2020 Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Vlorë, ka lëshuar një Vërtetim, nëpërmjet të cilës rezulton pasuri e paluajtshme, të përfituara me kontrata shitje nga Shoqëria Elda VI, e regjistruar në favor të M.M.

Me shkresën nr. 688, datë 31.12.2020 është bërë kërkesë për mbështetje në ekzekutim për datë 14.01.2021, drejtuar Komisarariatit të Policisë, Bashkisë Vlorë, kreditorit, debitorit dhe Ing. F.F.

Me datë 14.01.2021 është mbajtur procesverbal ku konstatohet se përmbaruesi u paraqit pranë vendit objekt ekzekutimi, në prezencë të punonjësit të policisë dhe përfaqësuesit të Bashkisë Vlorë. Bëhet i mundur ekzekutimi i vendimit duke çelur banesën, inventarizimi i sendeve të luajtshme, dhe lënia për ruajtje e tyre brenda banesës. Kreditorit i lihet afat prej dy muajsh për ruajtjen dhe magazinimin e sendeve të luajtshme. Firmosur nga kreditori, përmbaruesi K.K, F.K, punonjësi i policisë dhe përfaqësuesi i Bashkisë Vlorë.

Me shkresën nr. 750, datë 16.03.2021 është bërë njoftim për marrjen e sendeve të luajtshme, drejtuar debitorit, për dijeni dhe kreditorit.

Me datë 19.05.2021 është mbajtur procesverbal ku konstatohet ndër të tjera se u paraqitën në vendin objekt ekzekutimi dhe banesa i dorëzohet bosh kreditorit, të firmosur nga B.H, përmbaruesi K.K, të pranishmit, SPS dhe PNjV.

Me shkresën nr. 688, datë 02.09.2021 është bërë kërkesë për informacion drejtuar BKT-së, mbi vazhdimësinë e shlyerjes së kredisë së M.M dhe afatin e përfundimit, kundrejt BKT-së, pasi në kartelën e pasurisë rezulton shënimi “Hipotekuar në favor të BKT”.

Me shkresën nr. 5710/1, datë 23.09.2021 të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë, ka kthyer përgjigje se debitori M.M nuk figuron i regjistruar si tatim pagues në DRT Vlorë.

Me shkresën nr. 688, datë 24.09.2021 është bërë urdhër për vënien e masës sekuestro ekzekutive, drejtuar Raiffeisen Bank, për shumën 46 euro të bllokuara.

Me shkresën nr. 1019, datë 18.03.2022 të Z.P Vlorë është bërë urdhër për vënien e masës sekuestro konservative në llogari të debitorit, drejtuar Bankave të Nivelit të Dytë.

Referuar deklaratës së nxjerrjes së llogarisë së B.H të lëshuar nga Banka Credins datë 10.11.2021, rezulton se nga Z.P Vlorë është kaluar në llogarinë e ankuesit shuma prej 21.900 lekësh.

Ligji nr. 8730, datë 18.01.2001 *“Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor”*, i ndryshuar, në nenin 2⁵, të tij, ka përcaktuar se: *“1. Shërbimi i Përmbarimit Gjyqësor ka për mision ekzekutimin e detyrueshëm të titujve ekzekutivë, në rastet e përcaktuara në Kodin e Procedurës Civile. 2. Shërbimi i Përmbarimit Gjyqësor i ushtron funksionet nëpërmjet përmbaruesve gjyqësorë”*, ndërsa në nenin 3 është përcaktuar se: *“Shërbimi i Përmbarimit Gjyqësor ka organizim unik dhe të centralizuar, me shtrirje në të gjithë territorin e RSH”*.

Pika 1, e nenit 5⁶, të këtij Ligji përcakton se: *“Përmbaruesi gjyqësor është personi i ngarkuar me ligj për kryerjen e veprimtarisë së vënies në ekzekutim të titujve ekzekutivë, në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile”*.

Në nenin 8 të ligjit të mësipërm, parashikohen përgjegjësitë e Drejtorit të Përgjithshëm:

Drejtori i Përgjithshëm ka këto përgjegjësi:

- a) *Drejton dhe kontrollon veprimtarinë e Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor.*
- b) *Siguron zbatimin e njëjtë të akteve ligjore dhe nënligjore, si dhe të praktikave në fushën e veprimtarisë procedurale të ekzekutimit.*
-
- d) *Kontrollon dokumentimin e veprimtarisë përmbarimore.*
-

⁵ Objekti i veprimtarisë.

⁶ Përmbaruesi gjyqësor.

Në nenin 31 dhe 32 të ligjit të mësipërm, parashikohet se:

Neni 31; “Masat disiplinore.

1. Përmbaruesi gjyqësor, që shkel rregullat e parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore që lidhen me detyrën e tij ose nuk i zbaton ato, kur nuk ka vend për përgjegjësi penale, ndëshkohet me njërën nga këto masa disiplinore: a) Vërejtje me shkrim. b) Vërejtje me paralajmërim për shkarkim nga detyra. c) Shkarkim nga detyra.

2. Procedimi disiplinor fillon jo më vonë se 30 ditë nga çasti i vënies re të shkeljes dhe jo më vonë se 1 vit nga çasti i kryerjes së saj.

3. Nismën për fillimin e procedimit disiplinor e ndërmerr drejtori i përgjithshëm i Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor. Këshilli i Përmbarimit jep mendimin e tij brenda 15 ditëve nga fillimi i procedimit.

Në nenin 17 të Rregullores së Brendshme të Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor, të miratuar me Urdhërin nr. 6508, datë 07.10.2004, e Ministrit të Drejtësisë⁷, parashikohet se: “Drejtori i Përgjithshëm me konstatimin e abuzimeve në lidhje me kryerjen e detyrës nga përmbaruesi gjyqësor, shqyrton shkallën e abuzimit duke marrë masa administrative deri në kallëzim për ndjekje penale ndaj shkaktarëve që kanë kryer këto akte”.

Në nenin 515 të ligjit nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, përcaktohet se: “Urdhri i ekzekutimit vihet në ekzekutim nga shërbimi përmbarimor gjyqësor, shtetëror ose privat, me anë të përmbaruesit gjyqësor, në bazë të kërkesës së kreditorit...”.

Gjithashtu, neni 610⁸ i K.Pr.C., ka parashikuar shprehimisht, se, kundër veprimeve të përmbaruesit gjyqësor, të kryera në kundërshtim me procedurat e parashikuara nga ky Kod dhe kundër refuzimit të përmbaruesit gjyqësor për të kryer një veprim që ia ngarkon ligji, palët mund të bëjnë ankim në gjykatën që ekzekuton vendimin.

Lidhur me pretendimet e subjektit ankues për vonesat në ekzekutimin e vendimit të gjykatës dhe mosekzekutimin e vlerës së shpenzimeve gjyqësore dhe të tarifës përmbarimore, Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit, me shkresën nr. 123/3, datë 27.01.2022 dhe gjatë deklarimeve të bëra në seancën dëgjimore, datë 24.06.2022, ka informuar Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi se: “Drejtorja e Përgjithshme e Përmbarimit ka kryer hetim administrativ të dosjes përmbarimore të B.H si dhe ka trajtuar të gjitha kërkesat/ankesat⁹ e bërë nga ai dhe në përfundim është konstatuar se nga ana e Z.P Vlorë janë kryer të gjitha veprimet që parashikon Kodi i Procedurës Civile. Referuar akteve në dosje, të gjitha veprimet përmbarimore janë kryer nga Z.P Vlorë dhe përgjigjet e institucioneve kanë qenë negative dhe në këto kushte kur debitori nuk ka asnjë lloj pasurie të sekuestrueshme nga ana e palës debitore, nuk ka se ç’farë shume ti kthehet kreditorit, pasi janë ezauruar të gjitha procedurat ligjore”.

⁷ <https://dpp.gov.al/wp-content/uploads/2015/06/rregullore-e-brendshme-dpp.pdf>

⁸ Kundërshtimi i veprimeve të përmbaruesit gjyqësor.

⁹ DPP në përgjigje të ankesës së B.H, me shkresën nr. 123/3, datë 27.01.2022, në mes të tjerash ka informuar ankuesin se: Nga Z.P Vlorë janë kryer procedurat përmbarimore për ekzekutimin e vendimit nr. 293, datë 27.02.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Bazuar në sa më lart, lidhur me ligjshmërinë e veprimeve përmbarimore të kryera nga Z.P Vlorë, Komisioneri vlerëson se Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit si institucioni kryesor i ngarkuar me ligj për të kontrolluar veprimtarinë e përmbaruesve gjyqësorë, është shprehur qartë se nga ana e Z.P Vlorë, janë kryer të gjitha veprimet përmbarimore që parashikon Kodi i Procedurës Civile dhe se Z.P Vlorë do vijojë me procedurat përmbarimore në funksion të ekzekutimit të vendimit gjyqësor objekt shqyrtimi.

Në këto kushte, Komisioneri do shqyrtojë ankesën lidhur me trajtimin e pabarabartë të ankuesit nga ana e Z.P Vlorë krahasuar me kreditorë të tjerë pranë Z.P Vlorë.

Për të vlerësuar në lidhje me pretendimet e ankuesit, Komisioneri kërkoi nga Z.P Vlorë, kopje të dosjeve të tjera përmbarimore që janë në kushte të njëjta apo të ngjashme me ankuesin për të cilat Z.P Vlorë ka informuar se janë në proces ekzekutimi ose që janë pezulluar. Lidhur me këtë, Z.P Vlorë dërgoi kopje të dosjeve përmbarimore me objekt kthim shume të cilat janë ende në proces ekzekutimi, të shtetasve: 1. A.N, 2. B.K/V.K dhe 3. N.I.

Referuar dokumentacionit të dosjeve të sipërcituara rezulton se:

1. - Me Vendimin nr., datë 19.02.2021 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka lëshuar urdhërin e ekzekutimit për aktin noterial nr...., datë 26.02.2020 në emër të kreditorit A.N.
 - Z.P Vlorë me shkresën nr. 507, datë 06.04.2021 ka lajmëruar debitorin A.N për ekzekutimin vullnetar të vendimit të gjykatës, si dhe ka urdhëruar detyrimin e të paditurit ti kthejë shumën prej xxx euro, si dhe tarifën përmbarimore prej xxx lekë të parapaguar nga kreditori për llogari të Z.P Vlorë.
 - Z.P Vlorë me vendimin nr. 507, datë 20.04.2021, ka vendosur për kalimin menjëherë në ekzekutim të detyrueshëm të Urdhërit të Ekzekutimit nr. ..., datë 19.02.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.
 - Z.P Vlorë me urdhërin nr. 507, datë 20.04.2021, drejtuar Bankave të Nivelit të Dytë, Drejtorisë Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor dhe insitucioneve të tjera, ka urdhëruar vënien e sekuestros konservative në llogaritë e debitorit ..., në shumën prej xxx euro për tarifën përmbarimore të papaguar dhe bllokimin e dokumenteve të çdo automjeti që është në pronësi të palës debitore.
 - Z.P Vlorë me urdhërin nr. 1181, datë 22.04.2021, drejtuar Qendrës Kombëtare të Biznesit, ka urdhëruar vënien e sekuestros konservative për bllokimin e kuotave të kapitalit subjektiv
 - Z.P Vlorë me shkresën nr. 1181, datë 09.07.2021 drejtuar Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë, ka kërkuar kartelën e pasurisë së sekuestruar në emër të debitorit A.P, për të mundësuar vazhdimin e ekzekutimit me procedurat e ankandit.
 - Z.P Vlorë me Kërkesë Padinë nr. 1472, datë 17.11.2021 i është drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë për pjesëtim të sendit të përbashkët, pasurisë nr. dhe veçimin e pjesës takuese të debitorit bashkëpronar A.P.
2. - Me Vendimin nr., datë 09.09.2008 Gjykata e Shkallës së Parë e Rrethit Gjyqësor Fier ka lëshuar urdhërin e ekzekutimit si titull ekzekutiv të vendimit gjyqësor civil nr. 1499,

- datë 17.10.2003, të Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, lënë në fuqi me vendimin gjyqësor civil nr. ..., datë 19.05.2004, të Gjykatës së Apelit Vlorë, lënë në fuqi me vendimin gjyqësor civil nr., datë 11.03.2005 të Gjykatës së Lartë Tiranë.
- Me Vendimin nr. 565, datë 06.10.2008 të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbartimit, dosja përmbartimore nga Z.P Fier është transferuar në Z.P Vlorë.
 - Z.P Vlorë me vendimin nr. 1290, datë 25.11.2015, ka vendosur për kalimin menjëherë në ekzekutim të detyrueshëm të Urdhërit të Ekzekutimit nr. ..., datë 09.09.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, me kreditor B dhe V.K dhe debitor A.V.
 - Z.P Vlorë me urdhërin nr. 1290, datë 01.12.2015, drejtuar Bankave të Nivelit të Dytë, Drejtorisë Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor, Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë dhe Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Patundshme Vlorë, ka urdhëruar vënien e sekuestros konservative, në llogaritë e debitorit ..., në shumën prej xxx lekë, bllokimin e dokumenteve të çdo automjeti që është në pronësi të palës debitore A.V, vënien e sekuestros mbi pasuritë e paluajtshme prona ose bashkëpronësi të palës debitore dhe të kryhet bllokimi i çdo lloj dokumentacioni për aktivitetin tregëtar të debitorit.
 - Z.P Vlorë me urdhërin nr...., datë 20.02.2018 drejtuar Bankave të Nivelit të Dytë, Drejtorinë Rajonale Tatimore Vlorë, Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Patundshme Vlorë, Drejtorisë Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor, ka përsëritur dhe njëherë bllokimin e pasurive të debitorit A.V.
 - Z.P Vlorë me urdhërin nr., datë 26.03.2019, i është drejtuar përsëri Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Patundshme Vlorë për vënien e sekuestros mbi pasuritë e paluajtshme prona ose bashkëpronësi të palës debitore.
 - Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Patundshme Vlorë me shkresën nr. ..., datë 11.04.2019 është përgjigjur se nuk rezulton pasuri e paluajtshme e regjistruar në favor të shtetasit A.V.
3. - Me Vendimin nr., datë 04.03.2019 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka lëshuar urdhërin e ekzekutimit për aktin noterial nr...., datë 21.07.2018 në emër të kreditorit N.I.
- Z.P Vlorë me shkresën nr. 1331, datë 15.04.2019 ka lajmëruar debitorin S.A për ekzekutimin vullnetar të vendimit të gjykatës sipas deklaratës noteriale.
 - Z.P Vlorë me urdhërin nr. 1331, datë 15.05.2019, drejtuar Bankave të Nivelit të Dytë, Drejtorisë Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor, Drejtorinë Rajonale Tatimore Vlorë dhe Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Patundshme Vlorë, ka urdhëruar vënien e sekuestros konservative, në llogaritë e debitorit ..., në shumën prej xxx lekë, bllokimin e dokumenteve të çdo automjeti që është në pronësi të palës debitore A.V, të kryhet bllokimi i çdo lloj dokumentacioni për aktivitetin tregëtar të debitorit dhe vënien e sekuestros mbi pasuritë e paluajtshme prona ose bashkëpronësi të palës debitore.
 - Z.P Vlorë me shkresën nr. 1331, datë 20.05.2020 drejtuar Noterit E.A ka kërkuar çeljen e dëshmisë së trashëgimisë për trashëgimlënësin, pasi nga veprimet e kryera rezulton se debitori është një nga trashëgimtarët e radhës së parë të babait të tij.

Në analizë të veprimeve përmbartimore të kryera nga Z.P Vlorë rezulton se nga ana e kësaj zyre janë kryer të njëjtat veprime përmbartimore për ekzekutimin e vendimit të gjykatës, si për ankuesin B.H ashtu dhe për kreditorët e tjerë, të sjellë për krahasim nga Z.P Vlorë.

Rezulton se nga ana e Z.P Vlorë janë kryer veprimet përmbaremore si: Lajmërim për ekzekutim vullnetar; Vendim për kalim në ekzekutim të detyrueshëm; Kërkesë për marrjen e sendeve të luajtshme të debitorit në dorëzim; Urdhër për vënien e masës sekuestro konservative, drejtuar Bankave të Nivelit të Dytë, Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Patundshme Vlorë, Drejtorisë Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor dhe Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë.

Lidhur me kthimin e shumës për shpenzime gjyqësore, tarifë përmbaremore dhe shpenzime përmbaremore, të bëra nga B.H, nuk është bërë i mundur ekzekutimi i plotë i shumës, pasi nga përgjigjet e kthiera nga Bankat e Nivelit të Dytë nuk rezultojnë llogari me balancë pozitive në emër të debitorit M.M, ndërkohë që rezulton se në kartelën e pasurisë nr. 17/231-N30 të palës debitore M.M, për të cilën është vënë sekuestro konservative, rezulton shënimi “Hipotekuar në favor të BKT”, deri në datë 12.06.2026, kështu që deri në këtë datë Z.P Vlorë nuk mund të kryejë veprime përmbaremore lidhur me këtë pronë.

Diskriminimi përkuftizohet në nenin 3, pika 1 të Ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si nga ligjet në fuqi”*.

Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi¹⁰, i ndryshuar, ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrrohet se viktima e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Komisioneri, vlerëson se për sa më sipër, nuk konstatohet se ka shkelje të nenit 7/1, të Ligjit 10221/2020 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, nga ana e Zyrës Përmbaremore Vlorë, lidhur me trajtimin e dosjes përmbaremore të shtetasit B.H.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se ankuesi nuk është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe disfavorizues nga ana e Zyrës Përmbaremore Vlorë.

Në mungesë të një trajtimi të tillë nuk ekziston diskriminim për shkakun e pretenduar në ankesë.

¹⁰ Neni 7 i LMD-së, të ndryshuar, në pikën 1 të tij, parashikon se: *“Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”*.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në, nenin 1, nenin 7, pika 1, nenin 20 dhe 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 9-10, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të B.H, për shkak të etnisë, nga ana e Zyrës së Përmbaarimit Vlorë.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

KOMISIONERI

Robert GAJDA